

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ARCHORI” Construction and Engineering Services Sh.P.K

Sot, me date 17.06.2021 (dymije e njezete e nje), ortaku I vetem:

Z. **ERVIN HARDOLLI**, I biri I Gezim dhe Ermira, lindur me 28 Korrik 1995, ne Shkoder dhe banues ne Venezia, Itali, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi Shqiptare , mbajtes I leternjoftimit nr.033201689 dhe ID J50728099L

Kam vendosur hartimin dhe miratimin e statutit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “**ARCHORI Construction and Engineering Services Sh.p.k**”, bazuar ne kerkesat e ligjit **Nr.9901, date 14.04.2008** “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”.

KREU I

Themelimi,Emri,Kohezgjatja, Selia

NENI 1 _ EMERTIMI I SHOQERISE

- Shoqeria Tregetare do te quhet Shoqeria “**ARCHORI Construction and Engineering Services Sh.P.K**”

NENI 2 _ FORMA E SHOQERISE

- Shoqeria “**ARCHORI Construction and Engineering Services Sh.P.K**”, eshte e llojit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me Ortak te vetem, e krijuar dhe zoteruar nga une, themeluesi I saj, **Ervin Hardolli**.

NENI 3 _ QENDRA (SELIA) E SHOQERISE

- Shoqeria “**ARCHORI Construction and Engineering Services Sh.p.k**”, do te kete qendren (seline) e saj ne Fier, Lagjia Apollonia,Rruga Harrilla Bozdo, nr.32.
- Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra te tjera perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 4 _ KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

- Shoqeria “ARCHORI” Construction and Engineering service Sh.p.k do te veprojë per nje periudhe kohore te pacaktuar (pa afat)

KREU II

Regjimi juridik dhe objekti I Shoqerise

NENI 5 _ REGJIMI JURIDIK

- Ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, Shoqeria do te udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- Shoqeria gëzon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi dhe kerkesat e pergjithshme te kontabilitetit, sic sqarohen hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.
- Me vendim te Asamblese se Pergjithsme , Shoqeria mundet te ndryshoje formen ose regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat e Statutit te saj, duke bere edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.
- Shoqeria do te kete vullen e saj dhe gëzon afirmimin ligjor qe nga data e regjistrimit te saj ne Q.K.B.

NENI 6 _ OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Ne fushen e ndertimit: ne projektim dhe zbatim :Planvendosje objektesh te vecanta.,Projektim I strukturave te zakonshme prej murature tulle,guri,betony,b,armeje dhe metalike,Projektim vepra arti, Hartim dhe projektim I objekteve civile dhe industriale te te gjitha llojeve, Projektme ne fushen e infrastruktures rrugore,ujesjellesa,kanalizime te te gjitha llojeve, Projekte teknologjike te te gjitha llojeve ne fushen e industries si dhe projektme elektrike dhe hidraulike, Hartimi I projekteve ne fushen e mbrojtjes nga zjarri si dhe hartimi, studimi dhe vlersimi ne mjedis., Punime restaurime,Punime te dheut,sistemime,tarracime terrenesh,murature punime betoni dhe beton arme,punime te shembjes,kompletimi me instalime te brendshme te objekteve te ndertuara.,Ndertime civile dhe industriale.,Ndertime rruge kat.V,IV,III,II,I.,veshje me asfaltbeton te rrugeve (ndertim mbi shtresen) si dhe sistemim dhe asfaltim., Ndertime hekurudhore,punime special te shinave dhe

“ **ARCHORI** ” Construction and Engineering Services

binareve., Ndertim diga, tunele, galeri, villosa, kulla, kulla uji etj prej b, armeje, metalike. Themele te vecanta., Rikonstruksione godinash civile dhe industrial, veshje fasadash., Punime karpentjerie., Ndertimi I kapanoneve bujqesore, blektorale dhe industriale te te gjitha llojeve.

Prodhim, shitje, tregetim material inerte, asphalt, beton dhe te gjitha materialeve te tjera.

Shitblerje pasurish te paluajtshme. Dhenie konsulence ne fushen e shit-blerjes se pasurive te paluajtshme , si dhe ne te gjitha fushat object te veprimtarise se shoqerise.

Import eksport, prodhim dhe tregetim, me shumice dhe pakice te artikujve industrial, ushqimor, materialeve te ndertimit, paisjeve elektrike dhe elektronike, te makinerive te te gjitha llojeve, te pajisjeve dhe impjanteve te ndryshme te karakterit public, industrial, bujqesor, tregetar, ushqimor, mjekesor, farmaeutik, sportive, kulturor etj.

Kryerje e veprimtarive te sherbimit e riparimit te karakterit elektrik, elektronik, komunal, publicistik e te llojeve te tjera.

Perpunimin dhe prodhimin e dyerve, dritareve dhe paisjeve te ndryshme me duralumin , pvc dhe lendeve te ndryshme metalike dhe druri.

Kerkim , shfrytezim, nxjerrje, perpunim, tregetim, import dhe eksport te mineraleve te ndryshme si : krom, baker, kuarz, qymyr etj si dhe te nenprodukteve te tyre. Import, eksport, tregetim, magazinim dhe perdorim te lendeve te ndryshme plasese per qellime civile. Import , eksport, kerkim, shfrytezim, nxjerrje, perpunim dhe tregetim te hidrokarbureve, te burimeve natyrore: naftes dhe nenprodukteve te saj.

Riparim, prodhim mjete ujore.


Marrjen dhe dhenie me qira te paisjeve te ndertimit, te mjeteve te transportit per ndertim dhe tregetimin e tyre, blerje, shitje dhe dhenie me qera te automjeteve.

Tregetimi dhe montimi I paisjeve dhe aksesoreve per ambiente frigoriferike, per sera bujqesore.

Furnizim, vendosje , sherbime, mirembajtje te paneleve diellore.

Sipermarrje ne fushen e hoteleri-turizem dhe sherbimit si bare dhe restaurante, tregtim me shumice dhe pakice I pijeve alkolike dhe jo alkolike , import eksport I ktyre artikujve, transport mallrash dhe udhetaresh.

Date 17.06.2021



KREU III

Kapitali I regjistruar

NENI 7 _ KAPITALI I SHOQERISE.

Kapitali themeltar, fillestar I Shoqerise eshte 100.000 leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e Shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

- Ortaku themelues, **Ervin Gezim Hardolli**, zoterues I 1 kuote te kapitalit themeltar me vlere 100.000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.
- Lloji I kontributit : kontribut ne para me vlere 100.000 leke (njeqind mije).
- Kontributet ne para do te paguhen pasi Shoqeria te jete e regjistruar ne Q.K.B.

KREU IV

Te drejtat dhe detyrat e ortakeve

NENI 8 _ ORTAKET E SHOQERISE, KOMPETENCAT E TYRE.

Ortaku mban pergjegjesi per detyrimet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (prona te luajtshme ose te paluajtshme,ose te drejta)

Asetet e krijuara nga shoqeria gjate aktiviteteve te saj jane ne pronesi te ortakeve ne perputhjen me perqindjen e kuotave te zoteruara nga cdo ortak.

Kompetencat kryesore te ortakeve te shoqerise do te jene:

- 1- Te bejne ndryshime ne objektin e veprimtarise se shoqerise.
- 2- Te percaktojne politika tregtare te shoqerise ‘
- 3- Te bejne ndryshime ne statutin e shoqerise
- 4- Te emerojne dhe shkarkojne administratoret, likujduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar.
- 5- Te mbikeqyrin zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.



- 6- Te miratojne pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise .
- 7- Te miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
- 8- Te riorganizojne ose mbyllin shoqerine.
- 9- Te emerujne dhe shkarkojne nga detyra personelin e shoqerise dhe te percaktojne shperblimin qe u jepet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- 10- Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise, ai do te vendose zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe administrimit ekonomik.
Te gjitha vendimet e marra nga ortakët e shoqerise regjistruhen e nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

NENI 9 _ ABUZIMI I ORTAKEVE NDAJ SHOQERISE

Ortakët e shoqerise tregtare , qe kryejne nje ose me shume nga veprimet ose mosveprimet vijuese,pergjigjen personalisht e ne menyre solidare per detyrimet e shoqerise, me te gjithë pasurine e tyre nese :

- a) Abuzojne me formen e shoqerise tregtare per arritjen e qellimeve te paligjshme.
- b) Trajtojne pasurite e shoqerise tregtare sit e ishin pasurite e tyre.
- c) Ne castin kur kane marre apo duhet te kishin marre dijene per gjendje e paaftesise paguese te shoqerise, nuk marrin masat e nevojshme , per te siguruar qe shoeria, ne varesi te llojit te veprimtarise se ushtruar, te kene kapitale te mjaftueshme , per te permbushur detyrimet e marra persiper ndaj paleve te treat.

KREU V Administrimi I shoqerise

NENI 10 _ ADMINISTRATORET E SHOQERISE, KOMPETENCAT E TYRE

Administrimi I shoqerise do te behet nga administratori I cili eshte njekohesishte dhe ortaku I vetem I shoqerise , **Ervin Hardolli**, atesia Gezim, shtetas shqiptar, I datelindjes 28.07.1995, lindur ne Shkoder dhe banues ne Venezia, Itali, person madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes I kartes se identitetit me nr. 033201689.



Afati I emerimit 5 vjet me te drejte riperteritjeje. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Nese ortaku I vetem emerion me shume se nje administrator, ata do ta drejtojne se bashku shoqerine.

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- 1- Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga ortaku I vetem.
- 2- Perfaqesojne shoqerine ne marredhenie me te tretet, si dhe para te gjithave organeve shteterore.
- 3- Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullte te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise.
- 4- Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe ja paraqet ortakut te shoqerise per miratim.
- 5- Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne legjislacionin ne fuqi.
- 6- Raportojne ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe veprimtarine e shoqerise tregtare.

Per cdo ceshtje profesionale, juridike , ekonomike, teknike, etj, shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme , duke punesuar specialiste sipas legjislacionit ne fuqi.

KREU VI

Kushtet ekonomike te shoqerise

NENI 11 _ DISPOZITAT EKONOMIKE

- Veprimtaria ekonomike, financiare dhe tregtare e shoqerise realizohet dhe garantohet ne baze te legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- Per detyrimet e veta ne qarkullimin tregtar dhe juridik me persona te trete, shoqeria pergjigjet me pasurite e veta.
- Aktivi dhe pasivi I veprimtarise se shoqerise pasqyrohet ne planet ekonomike , financiare dhe tregtare te saj, te shprehura ne para shqiptare ose te konvertuara ne valute te huaj.
- Pasurite e shoqerise vlersohen ndermjet bilanceve ekonomiko-financiare dhe tregtare te saj, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.
- Te ardhurat e shoqerise, pasi te zbriten shpenzimet e amortizimit te pasurise se paluajtshme si dhe shpenzimet e tjera qe behen ne interest e

shoqerise, I takojne ortakut te vetem te shoqerise sipas dispozitave te percaktuara ne aktin e Themelimit dhe ne Statutin e krijimit te saj.

- Per detyrimet, shoqeria pergjigjet me fondet e veta.
- Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese, apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga ortakët e shoqerise.

NENI 12 _ VITI EKONOMIK

- Viti ekonomik fillon ne 1 Janar te cdo viti kalendarik dhe perfundon ne 31 Dhjetor te atij viti.

NENI 13 _ DHENIA E LLOGARISE EKONOMIKE

- Shoqeria funksionon ne baze te dispozitave ligjore, ekonomike ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, te dispozitave te Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj, si dhe programeve te vecanta qe do te hartoj une, ortaku i vetem per cdo vit ekonomik.
- Llogaria ekonomike e shoqerise mbeshetet ne llogarite e sherbimeve dhe te vetfinancimeve qe mbulon shpenzimet e veta.
- Shoqeria do te mbaje kontabilitetet ne baze te rregullave, metodave teknike kontabel ne gjuhen shqipe dhe ne lek shqiptare. Per mbajtjen e kontabilitetit do te perdoren Libri Ditar, Libri I Madh, Libri Inventar etj.
- Cdo forme organizimi e kontabilitetit do te mbahet e tille qe te mundesoje kryerjen e kontrollit te jashtem ne menyre te tille qe cdo ekspert kontabel te nxjerre nga librat kontabel nje pamje te pergjithshme te veprimeve te kryera.

NENI 14 _ RAPORTI VJETOR

Raporti vjetor I veprimtarise se shoqerise do te paraqitet ne formen dhe permbajtjen e percaktuar ne ligjin nr.9901, dt.14.04.2008 “per tregtetaret dhe shoqerite tregtare”.

KREU VII

Prishja e shoqerise, likujdimi

NENI 15 _ RASTET E NDERPRERJES SE VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Date 17.06.2021



Vendoset nderprerja e mardhenieve qe rrjellin nga 8statute dhe akti I themelimit te shoqerise kur per kete vertetohen arsye serioze sic mund te jene :

- 1- Veprimi I kushteve te forcave madhore
- 2- Varferimi I shoqerise
- 3- Dalja e nje vendimi nga organet kompetente qe ndalon veprimtarine e saj
- 4- Marrja e vendimit perkates nga ortaket e shoqerise


NENI 16 _ LIKUJDIMI

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likujdimi kryhet na likujduesit e emeruar nga ortaku I vetem. Nese asambleja e ortakut te vetem nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve , Brenda 30 diteve pas prishjes, cdo personi interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te percaktuar nje likuidues. Cdo person interesuar k ate drejte ti kerkoje gjykates zevendesimin e likujduesit , sipas vendimit te ortakeve, nese paraqet arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likuidimi I rregullt I shoqerise mund te cenohet nga likuiduesit e emeruar me siper. Kerkesa duhet te depozitohet ne gjykate brenda 30 diteve nga dita e caktimit te likuiduesit. Administratoret e shoqerise I njoftojne per regjistrimin, QKR, te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre per te perfaqesuar shoqerine , se bashku me dokumentat perkatese. Likujduesit depozitojne nenshrmin e tyre, I njoftojne gjithashtu Q.K.R per regjistrim cdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre te perfaqesimit. Emerimi I likuiduesve nga gjykta regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “Per qendren kombetare te regjistrimit”. Me hapjen e procedurave te likuidimit , emir I regjistruar I shoqerise ndiqet nga shenimi “ne likujdim”. Likujduesit duhet te ftojne kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Likujduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

KREU VIII Dispozita te fundit

NENI 17_ DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpallen ligje, dekrete, ose vendoset nje politike me e favorshme nga legjislacioni I pasqyruar ne aktin e statutin e krijimit te shoqerise, atehere, ne ortakët e saj, kemi te drejten tu drejtohem i organeve perkatese shteterore qe te zbatojne legjislacionin me te favorshem per ne dhe shoqerine e krijuar prej nesh.



NENI 18 _DISPOZITA TE VECANTA

- Te gjitha dokumentat e shoqerise do te permbajne adresen e plote te saj, numrin e rregjistrimit ne rregjistrin e QKB, si dhe numrin e regjistrit ne organin tatimor te njesise ku do te ushtroje veprimtarine e saj.
- Per ceshtje te tilla qe nuk parashikohen ne statut, veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne legjislacionin perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 19 _HYRJA NE FUQI

- Ky statut I perpiluar nga une, themelues dhe ortaku I vetem, ne 3 kopje te barabarta, hyn ne fuqi qysh ne momentin e nenshkrimimit nga ana ime.
- Ne rastet e likujdimit perfundimtar te shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi, pushon se vepruari edhe ky statut I saj.
- Krahas persosjes se metejshme te legjislacionit tregtar si dhe te ecurise se veprimtarise se shoqerise, gezohet e drejta e permirsimit te metejshem dhe te dispozitave te ketij statuti dhe te te gjithe dokumentave te shoqerise duke bere depozitimet perkatese sipas legjislacionit ne fuqi.

Statuti I mesiperme u nenshkrua nga une, ortaku I vetem I shoqerise, sot me date 17.06.2021.

ORTAKU THEMELUES

ERVIN HARDOLLI



**“ARCHORI” CONSTRUCTION AND ENGINEERING SERVICES
SH.P.K**